

Ditar Kabashi, MA¹

UDC:
342.4.04:323(560)"2017"

**MODELI TURK I SISTEMIT PRESIDENCIAL – RISITË,
VEÇORITË DALLUESE DHE SFIDAT E NDRYSHIMEVE
KUSHTETUESE TË VITIT 2017 NË REPUBLIKËN E TURQISË**

**ТУРСКИ МОДЕЛ НА ПРЕТСЕДАТЕЛСКИ СИСТЕМИ -
НОВИНИ, КАРАКТЕРИТИКИ И ПРЕДИЗВИЦИ НА
УСТАВНИТЕ ПРОМЕНИ ОД 2017 ВО РЕПУБЛИКА
ТУРЦИЈА**

**TURKISH MODEL OF PRESIDENTIAL SYSTEM –
INNOVATIONS, PECULIARITIES AND CHALLENGES OF THE
CONSTITUTIONAL CHANGES OF 2017 IN THE REPUBLIC OF
TURKEY**

Abstract

State power forms distinguish from one country to the other due to the political, socio-economic and traditional differences of societies. Turkey is a country where debates on governing system have constantly been present in the political life.

The long imperial tradition, the early period of the republic and authoritarian military interferences have always kept the idea fresh, ruling by a powerful political person, a leader to whom the country is entrusted to run. In politics, more than anything else, there have been attempts to give the priority to the institutional stability. The bitter

¹ LL.M. në të Drejtën Kushtetuese dhe Administrative. PhD. Cand. në Departamentin e të Drejtës Publike në Universitetin “Gazi” në Ankara. (ditarkabashi@gmail.com).

experience with the frequent falls of governments (less than a century, 65 established governments) built on the fragile coalitions, it was one of the factors to create the circumstances for an initiative to transform the system – from a parliamentary into a presidential system. Thus, it happened so and the referendum was held throughout Turkey on 16 April 2017 and the constitutional changes obtained the necessary majority of people's votes by becoming a part of the constitutional structure of the country.

Various articles of the constitution have undergone the essential changes. These changes have touched the constitutional definitions, laws and competencies of the legislative, executive and judiciary branches, by bringing forward some characteristic and uncommon constitutional provisions related to the classical presidential system.

This study tends to explain and treat theoretically the new constitutional changes in Turkey in the juridical-constitutional context, the innovations and the possible outcomes which may come due to their influence. The important point of the study will also be the relation of the legal norms with the separation of power principles, as a guarantee for a state of law.

Key words: constitutional changes, presidential system, separation of powers, president, parliament.

HYRJE

Ndryshimet kushtetuese janë procese të natyrshme që ngjajnë për faktin se vetë shoqëritë evoluojnë dhe transformohen e kjo doemos sjell nevojën e rirregullimit juridik të organizimit social. Garantimi dhe zbatimi i parimeve të pranura botërisht si vlera, siç janë mbrojtja e të drejtave të njeriut, demokracia, shteti i së drejtës, ndarja e pushteteve duhet të jenë ndër synimet jetësuese të secilit rend shtetëror.

Kushtetuta turke e vitit 1982² për herë të parë pësoi ndryshime më 1987, pra vetëm pak kohë pas hyrjes në fuqi. Që atëherë, kjo kushtetutë është ndryshuar 21 herë dhe kjo lë të kuptohet se ndërhyrjet e shpeshta e të shumta e kanë tjetërsuar në masë të konsiderueshme tekstin fillestar të saj. Pa dyshim, këtu nuk mund të mohohet fakti se kjo ka ngjarë edhe për shkak se atë e kanë hartuar ushtarakët puçistë të

² Kjo Kushtetutë është miratuar nga Kuvendi Themelues më 18.10.1982 dhe është paraqitur në referendum më 7.11.1982. Pas votimit pro të qytetarëve, me datë 9.11.1982 është shpallur në Gazetën Zyrtare. Shih: https://www.tbmm.gov.tr/anayasa/anayasa_2011.pdf. (28.04.2018).

vitit 1980 dhe si e tillë ka rezultuar me pakënaqësitë e vazhdueshme të politikës civile dhe qytetarëve në përgjithësi duke pasur për qëllim që aktin autoritar të juntës ushtarake ta ndryshojnë ose edhe ta zëvendësojnë me një kushtetutë të re.

Në Turqi, ideja për të kaluar në presidencializëm ka qenë më e hershme dhe kjo është proklamuar nga zyrtarë të lartë të shtetit.³ Ndërkaq zgjedhja e drejtpërdrejtë e presidentit është vënë si rregull në Turqi në vitin 2007, pas një krize për të zgjedhur presidentin⁴ në Parlament.⁵ Ligji që sillte këtë risi parashihte ndryshime në mandatin, rizgjedhjen dhe rregullat e tjera të procesit zgjedhor presidencial.⁶ Përcaktimi i tillë normativ dhe zbatimi i parë i kësaj dispozite më 2014, ka aktualizuar nevojën për ridefinimin e pozitës së presidentit. Legjitimimi popullor dhe besimi i fituar në zgjedhje demokratike, *de facto* veçse e kishte ndërruar edhe natyrën e shefit të shtetit. Pra, nga një president me kompetenca kryesisht simbolike, filloi të dalë në pah një president me karakter më ekzekutiv. Pashmangshëm, kjo do të çonte në një model të ri qeverisjeje.⁷

Ndryshimet kushtetuese që do të ndërrojnë trajektoren e regjimit politik i janë paraqitur votuesve turq në referendum. Në këtë proces janë ofruar argumente e kundërgargumente për projektligjin e ndryshimeve kushtetuese.⁸ Gjatë fushatës për referendumin, nga studiues të

³ Për shembull, ish-presidentët Demirel dhe Özal kishin potencuar nevojën për diçka të tillë Shih: ERGÜDER, Üstün. *Başkanlık mı, Parlamenter Sistem mi?*. Cem Akaş (derleyen). *Kritik Kavşak Parlamenter Sistem – Başkanlık Sistemi*. Koç Üniversitesi Yayınları, İstanbul, 2015. f. 128.

⁴ Në historinë e afërt politike në Turqi, kjo njihet si kriza “367”, e cila ngjau pas një vendimi kontradiktor të Gjykatës Kushtetuese rreth kuorumit të nevojshëm për zgjedhjen e presidentit në Parlament. Rreth paraqitjes së krizës dhe tejkallimit të saj, shih: ASLAN, Ali; MİŞ, Nebi; EREN, Abdullah. *“Türkiye’de Cumhurbaşkanlığı’nın Demokratikleşmesi”*. f. 18-23. http://file.setav.org/Files/Pdf/20140808184540_turkiye%E2%80%99de-cumhurbaskanligi%E2%80%99nin-demokratiklesmesi-pdf.pdf. (21.04.2018).

⁵ Organi legjislativ në Turqi është Kuvendi i Madh Popullor i Turqisë (në origjinalin turqisht: Türkiye Büyük Millet Meclisi; shën. i autorit). Për të mos e ngarkuar tekstin e këtij punimi, do të përdoret emërtimi sinonimik “Parlamenti”.

⁶ Shih: *Cumhurbaşkanı Seçimi Kanunu, Kanun No. 6271*. <http://www.mevzuat.gov.tr/Metin.Aspx?MevzuatKod=1.5.6271&sourceXmlSearch=&MevzuatIliski=0>. (19.04.2018)

⁷ Shih: KABASHI, Ditar. *“Pozita e kreut të shtetit gjatë zhvillimit kushtetues në Republikën e Turqisë – Shqyrtime krahasuese”*. Artini, Prishtinë, 2016. f. 45.

⁸ Për të krahasuar pretendimet e taborëve politike gjatë kampanjës së Referendimit të 16 prill 2017-tës, shih: *“The 2017 Constitutional Referendum in Turkey”*. Daily

ndryshëm kishte kritika se përkrahësit dhe kundërshtuesit e propozimit për ndryshime kushtetuese, në vend se të analizonin pakon, në qendër të diskutimit vendosnin “individin”. Kjo do të shpiente në personalizimin e referendumit dhe si rrjedhojë do të nënkuptonte votimin pro ose kundër të një personi, gjë që do të mund ta shndërronte procesin në një plebishit.⁹ Si përfundim, rezultati i referendumit doli në favor të ndryshimeve.¹⁰

Avokuesit e ndryshimeve kushtetuese të vitit 2017 pohonin se sistemi i ri presidencial turk do të rrisë efikasitetin dhe efektivitetin e ekzekutivit si dhe do të bëjë rritjen e performancës në shërbime, do të fuqizojë politikën e sigurisë kundër terrorizmit, do të zbusë polarizimin në politikë, meqë presidenti do të zgjidhet me mbi 50% të votave, do të fuqizojë organin legjislativ, pasi të drejtën e propozimit të ligjeve do ta ketë ekskluzivisht vetëm Parlamenti, etj.¹¹

Disa studiues pohojnë se ndryshimet kushtetuese të vitit 2017 në fokus nuk kishin demokratizimin e mëtejshëm të kushtetutës dhe realisht ndodhën si rezultat i destabilizimit politik, që ishte pasojë e mos respektimit të kornizave të kompetencave që i parashihte Kushtetuta e vitit 1982.¹²

Pakoja me ndryshimet kushtetuese ka sjellë risi të shumta në organizimin shtetëror dhe gjithashtu ka prekur një numër të konsiderueshëm nenesh kushtetuese.¹³ Ligji për ndryshimet kushtetuese përbëhet

Sabah Centre for Policy Studies. https://www.turkheritage.org/Uploads/715d3c66acf453a7198370af74888b33_Cd5e8NGc.pdf. (22.04.2018).

⁹ Sipas studiuës Gönenc, “*Një cilësi e tillë e referendumit do të vendoste në plan të parë “individin” gjersa “institucionet” do të mbeteshin mbrapa. Në fakt individët shkojnë e vijjnë kurse institucionet mbesin*”. Shih: GÖNENÇ, Levent. “*2017 Anayasa değişikliği sürecine dair notlar*”. f. 10. http://www.tepav.org.tr/upload/files/1493836530-7.2017_Anayasa_Degisikligi_Surecine_Dair_Notlar.pdf. (23.04.2018).

¹⁰ Në votimet e referendumit ku morën pjesë 85.43% e qytetarëve me të drejtë vote, pro pakos së ndryshimeve ishin 25.157.463 votues, ndërsa numri i votuesve kundër ishte 23.779.141. të dhënat zyrtare në faqen e Këshillit të Lartë të Zgjedhjeve (turqisht: Yüksek Seçim Kurulu): <https://sonuc.ysk.gov.tr/module/sspsHalkoylamasiYeni.jsf>. (22.04.2018).

¹¹ Shih: KUZU, Burhan. “*Her Yönü ile Başkanlık Sistemi Yeni Sistem Cumhurbaşkanlığı Modelimiz*”. Babıali Kültür Yayıncılığı, İstanbul, 2017. f. 198-199.

¹² Shih: DOĞAN, İlyas. *Türk Tipi Başkanlık Modeli Bağlamında 2017 Anayasa Değişikliğinin İrdelemesi*. DOĞAN, İlyas; ÜNVER, Serdar. (editör). “*Dört Kitada Başkanlık Sistemi*”. Astana Yayınları, Ankara, 2017. f. 26.

¹³ Për të krahasuar tekstin kushtetues të mëparshëm dhe ndryshimet përkatëse në secilin nen, shih: ÖZMEN, Remzi (hazirlayan). “*Referandum Değişiklikleri Sonrası Karşılaştırmalı Türkiye Cumhuriyeti Anayasası 1982-2017*”. Seçkin Yayıncılık,

nga 18 nene.¹⁴ Secili nga këta rregullon një fushëveprim të caktuar me karakter kushtetues.

1. NDRYSHIMET LIDHUR ME PUSHTETIN LEGJISLATIV

1.1. Zgjedhjet e përbashkëta parlamentare dhe presidenciale

Risi në organizimin e procesit elektoral është se zgjedhjet parlamentare dhe ato presidenciale do të mbahen çdo pesë vjet, në të njëjtën ditë. Në rast se presidenti nuk do të zgjidhet në votimin e parë organizohet rundi i dytë i zgjedhjeve presidenciale (neni 77).

Në opinionin e hartuar për çështjen e ndryshimeve kushtetuese në Turqi, Komisioni i Venedikut vë theksin në faktin e organizimit të zgjedhjeve të përbashkëta parlamentare e presidenciale duke potencuar mundësinë që presidenti të ketë shumicën parlamentare nga partia e tij dhe në këtë mënyrë lehtësisht të kontrollojë edhe veprimtarinë e legjislativit duke lëkundur themelet e parimit të ndarjes së ngurtë të pushteteve të paraparë me sistemin presidencial.¹⁵

1.2. Zgjedhja e deputetëve

Numri i deputetëve është rritur nga 550 në 600 (neni 75). Që nga miratimi i kushtetutës në vitin 1982, Turqia ka shtuar popullatën e saj. Si rrjedhojë, propozimi ka pasur tendencë të rritjes së përfaqësimit të qytetarëve në Parlament.

Po ashtu, ka ndryshuar edhe mosha e fitimit të së drejtës për të t'u zgjedhur deputet. Kriteri i mëhershëm prej 25 vjeç tani është zbritur në 18 vjeç (neni 76). Ulja e moshës si kriter për t'u zgjedhur është konform standardeve bashëkohore demokratike meqenëse 18-vjeçarët veçse

Ankara, 2017. Gjithashtu për formë elektronike, shih: http://anayasadegisikligi.barobirlik.org.tr/Anayasa_Degisikligi.aspx. (16.04.2018).

¹⁴ Ndryshimet kushtetuese janë votuar në Parlament me Ligjin për Ndryshime Kushtetuese no. 6771 të datës 21.01.2017. (origjinali në turqisht: *Türkiye Cumhuriyeti Anayasasında Değişiklik Yapılmasına Dair Kanun*) <https://www.tbmm.gov.tr/kanunlar/k6771.html>. (18.04.2018).

¹⁵ Shih: European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission). "Turkey Opinion on the Amendments to The Constitution Adopted By The Grand National Assembly On 21 January 2017 And To Be Submitted To A National Referendum On 16 April 2017." Opinion No. 875/2017. Strasbourg, 13 March 2017. [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=cdlad\(2017\)005-e.f.23](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=cdlad(2017)005-e.f.23). (27.04.2018).

kishin të drejtë vote, por nuk kishin të drejtë të kandidoheshin për t'u zgjedhur dhe kjo në njëfarë mënyre paraqiste një kontradiktë më vete. S'do mend se Parlamenti nuk do të mbushet me të rinj të papërvojë dhe hapja rrugë për këtë nuk paraqet dëm për demokracinë.

1.3. Kuorumi në Parlament

Kuorumi i mbajtjes së seancave në Parlament, përfshirë ato në të cilat ndodhin zgjedhje, është së paku 1/3 e të gjithë deputetëve. Parlamenti, përveç nëse është paraparë ndryshe me Kushtetutë, merr vendim me shumicë të thjeshtë; mirëpo në asnjë rrethanë kuorumi për vendimmarrje nuk mund të jetë më pak se 1/4 plus një deputet (neni 96). Meqenëse është rritur numri i deputetëve, i bie që për mbajtje të seancës duhet të jenë së paku 200 deputetë në sallë kurse minimumi për vendimmarrje është 151 deputetë.

1.4. Instrumentet e kontrollit parlamentar

Sipas versionit të mëhershëm të Kushtetutës së vitit 1982, kontrolli parlamentar njihete pesë instrumente: pyetjen parlamentare, hetimin parlamentar, debatin parlamentar, interpelancën dhe padinë parlamentare.¹⁶

Para së gjithash duhet theksuar se Parlamentit i hiqet kompetenca e kontrollit mbi Këshillin Qeveritar dhe anëtarët e saj si dhe autorizimi i qeverisë për nxjerrjen e dekretligjeve në çështje të caktuara¹⁷ dhe kjo është e natyrshme meqë në sistemin presidencial nuk ka këshill qeveritar por kabinet të presidentit.

Ndryshimet e reja kanë prekur edhe instrumentet kontrolluese të organit legjislativ kundrejt atij ekzekutiv.¹⁸ Në formën e tyre të vjetër janë ruajtur vetëm hetimi parlamentar dhe debati parlamentar, ndërsa janë përcaktuar disa kushte shtesë për padinë parlamentare.¹⁹ Pyetja parlamentare është kufizuar vetëm në formë të shkruar drejtuar

¹⁶ Për sqarime më të hollësishme rreth fuqisë juridike të këtyre instrumenteve të kontrollit parlamentar, shih: GÖZLER, Kemal. "Anayasa Hukukuna Giriş". Ekin Basım Yayın Dağıtım, Bursa, 2015. f. 261-268.

¹⁷ Neni 87 i Kushtetutës.

¹⁸ Neni 98 i Kushtetutës rregullon hapësirën kontrolluese të organit legjislativ.

¹⁹ Padia parlamentare si instrument parlamentar mund të përdoret vetëm për të iniciuar hetimin penal ndaj presidentit. Në bazë të kësaj rruge, presidenti mund të paditet në Gjykatë Kushtetuese nën akuzën e kryerjes së ndonjë vepre penale. Për këtë arsye në shqip është përkthyer si "padi parlamentare" (shën. i autorit). Trajtimi përkatës lidhur me këtë çështje do të bëhet më poshtë, nën titullin "Përgjegjësia penale e presidentit".

zëvendëspresidentëve dhe ministrave, ndërkaq mocioni është fshirë në tërësi.²⁰ Ekziston pikëpamja se pamundësia e pyetjes verbale për ministrat në Parlament, siç është praktikë në SHBA, mund të konsiderohet si një mangësi e rëndësishme.²¹

1.5. Çështja e buxhetit

Buxheti është armë e rëndësishme dhe efektive e organit legjislativ kundrejt atij ekzekutiv. Sipas ndryshimeve kushtetuese, në rast se Parlamenti nuk e miraton projektbuxhetin e propozuar nga presidenti, derisa të nxirret ligji i ri për buxhetin do të vazhdohet me lartësinë e rivlerësuar të buxhetit të vitit paraprak (neni 161). Mund të thuhet se kjo është menduar si rrugëdalje nga kriza eventuale që mund të ngjajë mes legjislativit dhe ekzekutivit kur në pyetje është miratimi i buxhetit. Kur kihet parasysh se sot edhe në SHBA kërkohet një zgjidhje për të tejkaluar një problem të tillë, mund të thuhet se përgatitja e një buxheti të përkohshëm bazuar në buxhetin e vitit paraprak paraqet një rrugëdalje nga bllokada eventuale.²² Mirëpo edhe këtu mund të ketë një rrezik. Kompetenca mbi buxhetin është arma e fundit e legjislativit kundrejt ekzekutivit. Duke ia mundësuar presidentit që të vazhdojë me buxhetin e vjetër, me këto ndryshime, Parlamenti i konfiskohet edhe kjo armë e fundit.²³ E sistemi presidencial që synon organe të fuqishme dhe të pavarura nga njëra-tjetra nuk mund të jetësohet në plotni me praktika të tilla.

2. NDRYSHIMET LIDHUR ME PUSHTETIN EKZEKUTIV

Kur bëhet fjalë për presidencializmin, perceptimi fillestar konsiston në një sistem në të cilin figurë qendrore e skenës politike dhe vendimmarrëse është presidenti. Duke qenë se epiqendër e ndryshimeve kushtetuese ka qenë pikërisht pushteti ekzekutiv, në vijim do të paraqiten pikat kryesore që kanë ridizenjuar këtë pushtet në Republikën e Turqisë.

²⁰ Mosparashikimi i mocionit të interpelancës si mekanizëm i kontrollit është në përputhje me natyrën e sistemit presidencial.

²¹ Shih: COŞKUN, Vahap. “16 Nisan 2017 Tarihinde Kabul Edilen Anayasa Değişikliklerinin Değerlendirilmesi”. DÜHFD, Cilt: 22, Sayı: 36, Yıl: 2017, f. 3-30. <http://dergipark.gov.tr/download/article-file/322749>. (17.03.2018).

²² GÜLENER, MİŞ. *op. cit.* f. 72.

²³ GÖZLER, “Elveda...”, f. 67.

2.1. Kandidimi dhe definimi kushtetues i Presidentit të Republikës

Ndryshimet kushtetuese kanë rregulluar çështjen e kandidaturës për president.²⁴ Kandidat për kryetar shteti mund të propozojnë grupet politike parlamentare, së paku 100.000 (njëqind mijë) votues dhe partitë që kalojnë pragun prej 5% të votave të përgjithshme. Krahasuar me të kaluarën ky paraqet një hap progresiv në aspektin e zhvillimit të demokracisë.²⁵ Me anë të këtij ndryshimi, më shumë shtresa të shoqërisë do të kenë mundësinë të përfshihen aktivisht në procesin e zgjedhjes së presidentit dhe kjo do të kontribuojë në fuqizimin e pluralizmit në vend. Përkundër kësaj, siç shihet, e drejta për të shpallur kandidaturën për president në Parlament i takon vetëm grupeve parlamentare. Këtu del në pah pamundësimi që i bëhet deputetëve për të shpallur kandidatura si individë. Rrjedhimisht, mbizotërues do të jetë qëndrimi kolektiv partiak. Kjo situatë mund të interpretohet si kufizuese për veprimtarinë e pavarur të deputetëve.

Presidentit të Republikës i shtohet edhe cilësia “kryetar i shtetit” dhe me këtë cilësi përfaqëson unitetin e popullit dhe garanton zbatimin e kushtetutës dhe funksionimin e rregullt dhe harmonik të organeve shtetërore. Gjithashtu i njihet kompetenca si kreu i ekzekutivit.²⁶ Kjo domethënë se pozita e kreut të shtetit dhe ajo e kreut të ekzekutivit fuzionohen në një person të vetëm. Rrjedhimisht krijohet monocefalizmi si lloj i pushtetit ekzekutiv.

2.2. Ruajtja e lidhjes organike së presidentit me partinë

Tanimë presidentit i hiqet ndalesa kushtetuese që të vazhdojë lidhjen me partinë e vet (neni 101). Kështu, është fshirë fjala “i paanshëm” që i atribuohet presidentit në versionin paraprak të Kushtetutës. Kjo për shkak se më presidenti nuk do të detyrohet që të shkëpusë lidhjet me partinë e vet (nëse i ka).²⁷ Në këtë mënyrë është përligjur në rrafshin konstitucional mundësia që presidenti të jetë “i anshëm”. Mirëpo fjala “paanshmëri” ka ruajtur vendin që kishte në nenin 103 i cili përcakton mënyrën e betimit të presidentit me rastin e marrjes së detyrës. Pra, një president që mund të jetë i anshëm do të betohet se

²⁴ Shih nenin 101 të Kushtetutës.

²⁵ Sipas versionit paraprak të Kushtetutës së vitit 1982 shifra e nevojshme për këtë ishte 10%.

²⁶ Për detyrat dhe kompetencat e tjera të presidentit, shih nenin 104 të Kushtetutës.

²⁷ Kjo normë ka hyrë në fuqi menjëherë pas referendumit.

detyrën do ta kryejë me paanshmëri. Kjo paraqet një situatë kontradiktore dhe i duhet gjetur zgjidhja.²⁸ Në sistemet presidenciale të qeverisjes nuk paraqet problem që presidenti të jetë partiak mirëpo me ndryshimet kushtetuese në Turqi presidentit i lejohej që njëkohësisht të jetë edhe kryetar partie.²⁹

Në sistemin presidencial Parlamenti merret me legjislacionin, ndërsa presidenti me çështjet ekzekutive. Kështu, në rast se presidenti ushtron edhe funksionin e kreut të partisë, fare lehtë mund ta kontrollojë grupin parlamentar të partisë së vet. Kjo mund të paraqesë probleme në kontekst të parimit të ndarjes së pushteteve, sepse “të ngrënit me dy lugë nga ana e presidentit mund ta cenojë ndarjen e duhur ndërmjet legjislativit dhe ekzekutivit”.³⁰ Po ashtu, kjo risi institucionin e presidentit mund ta zhvendosë në polemika të vazhdueshme politike.³¹

Duke marrë për bazë funksionimin e sistemit të ri, stabilitet mund të ketë në rastet kur presidenti do të sigurojë një shumicë parlamentare prej 1/2 ose 3/5. Nëse mungon shumica absolute në Parlament mund të gjenerohet kaosi politik kurse në rast të sigurimit mbi 3/5 e deputetëve mund të humbasë mekanizmi i balancit - përfshirë gjyqësorin dhe zgjedhjet e parakohshme dhe kështu, nën tensionin e autoritarizmit, do të vështirësohet funksionimi i shëndoshë i sistemit të ri.³² Kur kësaj i shtohet edhe disiplina e ngurtë përbrenda partive politike në Turqi mbetet të shihet niveli i pavarësisë së deputetëve përballë pushtetit ekzekutiv.

Në të vërtetë, duke qenë se presidenti është shef i ekzekutivit, kemi të bëjmë me sistem presidencial, mirëpo kur marrim parasysh faktin se ai njëkohësisht mund të ushtrojë edhe detyrën e kreut të partisë, kjo na lë të kuptojmë se ka ngjashmëri me pozitën e kryeministrit në sistemin

²⁸ COŞKUN, *op. cit.* f. 14.

²⁹ Në kuadër të kësaj, profesori Gözler paraqet kritikën e vet me këtë pyetje: “Një president që deri në mesditë mban fjalim në kongresin partiak dhe kërkon vota nga delegatët, ndërsa pasdite emëron gjyqtarë të lartë, shefin e Armatës e rektorë universitetesh, sa mund të jetë kompatibil me paanshmërinë e këtyre zyrtarëve?” Shih: GÖZLER, Kemal. “*Elveda Anayasa*”. Ekin Basım Yayın Dağıtım, Bursa, 2017. f. 69.

³⁰ COŞKUN, *op. cit.* f. 15.

³¹ DOĞAN, *op. cit.* f. 26.

³² Duke e vërejtur këtë situatë, Ulusoy ofron dy zgjidhje të mundshme: e para, themelimin e një parlamenti bikameral dhe e dyta, ndryshimin e sistemit zgjedhor. Shih: ULUSOY, Ali D. “*Aralık 2016 Anayasa Teklifi Neler Getiriyor, Neler Götürüyor?*”. f. 4-6. <http://www.anayasa.gen.tr/ulusoy-anayasa-degisikligi.pdf>. (08. 04. 2018).

parlamentar ku i njëjti edhe është shef qeverie, edhe mund të jetë kryetar partie. Pra, në dukje kemi shuarjen e pozitës së kryeministrit, por duke i marrë atributet e kryeministrit në një të anë dhe duke mos u detyruar të jetë i paanshëm në anën tjetër, praktikisht roli i presidentit në Turqi do të jetë më tepër me karakter kryeministrot. Nga kjo perspektivë mund të konkludohet se *de jure* është shuar pozita e kryeministrit, gjersa *de facto* pikërisht ajo e presidentit si simbol uniteti.

2.3. Mandati i presidentit dhe përtrirja e zgjedhjeve

Ndër pikat esenciale të sistemit presidencial është edhe përcaktimi i ngurtë i mandatit qeverisës. Presidenti mund ta ushtrojë detyrën jo më shumë se dy herë. Edhe me sistemin e ri turk, parimisht, presidenti mund të zgjidhet dy herë me mandat pesëvjeçar. Mirëpo mund të flitet për një përjashtim të mundshëm nga ky rregull. Në këtë kontekst, hipotetizohet janë dy mundësi. E para, nëse gjatë mandatit të dytë të presidentit Parlamenti vendos që t'i përtrijë zgjedhjet,³³ presidentit i lind e drejta që të kandidohet përsëri.³⁴ Ky rregull i mundëson një presidenti që matematikisht të mund të qëndrojë në pozitë diku rreth 14 vjet.³⁵ E dyta, në rast të mbetjes vakant të postit presidencial dhe për organizimin e zgjedhjeve të rregullta parlamentare është një periudhë më tepër se një vjeçare, zgjedhjet presidenciale mbahen brenda 45 ditësh. Presidenti i sapozgjedhur ushtron detyrën deri në ditën e zgjedhjeve parlamentare dhe ky interval kohor nuk do t'i llogaritet si “mandat presidencial”. E nëse më pas i njëjti zgjidhet president për dy mandate, falë këtij rregulli i bie që të mund të jetë në këtë funksion mbi 10 vjet.³⁶ Që kjo çështje të mos paraqiste problem, mund të ndiqeshin dy rrugë: e para, të veprohej në harmoni me sistemin presidencial klasik duke mos iu njohur e drejta e përtrirjes së zgjedhjeve Parlamentit dhe presidentit; e dyta, të vendosej që zëvendëspresidenti të zgjidhej po

³³ Sipas tekstit kushtetues, zgjedhjet e parakohshme quhen “përtrirje e zgjedhjeve” (në origjinalin turqisht: “seçim yenileme”; shën. i autorit).

³⁴ Mundësia e dhënë që i hap rrugën për kandidimin e tretë është arsyetuar me faktin se presidentit i ndërpritet mandati jashtë vullnetit të tij dhe pa bekimin e popullit.

³⁵ Deri këtu mund të vijë në rast se presidenti mund të përpiqet që vendimin për zgjedhje të parakohshme t'ia imponojë grupit të vet parlamentar nëse e ka shumicën e nevojshme.

³⁶ Një rast hipotetik për ilustrim mund të jetë ky: nëse ndodh që presidenti vdes vetëm pak kohë pasi të ketë ardhur në krye të detyrës, i sapozgjedhuri president do ta plotësojë pjesën e mbetur të mandatit por pa iu llogaritur si mandat. Prandaj i njihet e drejta që të mund të kandidohet edhe për dy mandate të tjera.

ashtu nga populli. Në këtë mënyrë, në rast të mbetjes vakant të postit të presidentit, në detyrë do të vinte zëvendëspresidenti, i cili tani më do të kishte legjitimitet demokratik.³⁷

Ndër risitë që ka sjellë pakoja me ndryshime kushtetuese është edhe forma e organizimit të zgjedhjeve të parakohshme. Një vendim të tillë ka të drejtë ta marrë presidenti ose Parlamenti. Në Parlament, për këtë vendim duhen 3/5 e numrit të përgjithshëm të deputetëve dhe në këtë rast presidentit i lind e drejta që të kandidohet përsëri. Mandati i të dy organeve është pesëvjeçar (neni 116). Sipas kësaj, presidenti pa asnjë parakusht mund të vendosë që të përtrihen zgjedhjet. Në një rast të tillë, në bazë të parimit të reciprocitetit, nënkuptohet se edhe vetë ai do t'i nënshtrohet garës zgjedhore. Bazuar në këtë karakteristikë, sistemi i ri i ngjason më tepër sistemit parlamentar se sa atij presidencial.³⁸

Siç dihet, ndër cilësitë më themelore të sistemit presidencial është pavarësia ndërmjet organit legjislativ dhe atij ekzekutiv. Kjo domethënë se Parlamenti dhe presidenti nuk e zgjedhin dhe as e shkarkojnë njëri-tjetrin ngase që të dy palët në detyrë vijnë me votën e drejtpërdrejtë të popullit.³⁹ Ndërkaq, në Turqi edhe pse të dy organet legjitimitetin e marrin nga populli, rezervojnë të drejtën t'i japin fund mandatit të njëri-tjetrit. Kësaj edhe n'i thënjn "shpërbërje e ndërsjellë"⁴⁰ ose edhe "përtrirje e ndërsjellë e zgjedhjeve", në praktikë do ta ketë pasojën e njëjtë.⁴¹ Megjithëkëtë, ekziston edhe opinioni se

³⁷ COŞKUN, *op. cit.* f. 16-17.

³⁸ GÖZLER, "Elveda...", f. 57.

³⁹ Për më tepër, shih: GÜL, Cengiz. "Karşılaştırmalı Hükümet Sistemlerinde Yürütme". Yetkin Yayınları, Ankara, 2017. f. 140-142.

⁴⁰ Fjala është për dhënien fund të mandatit të njëri-tjetrit. Në origjinalin turqisht është "karşılıklı fesih" që në këtë punim është përkthyer "shpërbërje e ndërsjellë" (shën. i autorit). Hartuesit e ndryshimeve kushtetuese nuk e kanë përdorur këtë term dhe në vend të tij kanë përzgjedhur shprehjen "përtrirje e zgjedhjeve" (origjinali turqisht: "seçimleri yenileme"; shën. i autorit).

⁴¹ Lidhur me këtë çështje, Gözler thotë: "Që të bëhet fjalë për kompetencën e "shpërbërjes" në të drejtën kushtetuese të një vendi, në atë kushtetutë nuk është e domosdoshme të përmendet fjala "shpërbërje". Nëse kushtetuta e tillë shefët të shtetit ia njeh kompetencën e përtrirjes së zgjedhjeve parlamentare para mbarimit të mandatit të rregullt, pavarësisht se cilin term e përdor, kemi të bëjmë me kompetencën e "shpërbërje". Shih GÖZLER, Kemal. "Referandumdan Önce, Referandumdan Sonra". Ekin Basım Yayın Dağıtım, Bursa, 2017. f. 19. Opinioni të ngjashëm paraqet edhe konstitucionalisti Özbudun. Në një intervistë të tijën, ai thotë se "shpërbërja e ndërsjellë" dhe "përtrirja e zgjedhjeve" janë nocione sinonimike që kanë një dallim të vogël teknik mes vete por që janë të njëjta në lindjen e rezultatit. Shih: <http://t.thenewyoungturk>.

dhënia fund e ndërsjellë e mandatit të këtyre dy organeve kushtetuese nuk bjen në kundërshti me thelbin e sistemit presidencial.⁴²

2.4. Dekretet presidenciale

Ndryshimet kushtetuese presidentit ia njohën edhe kompetencën e nxjerrjes së dekretëve. Në fakt, edhe në versionin paraprak të Kushtetutës, ku sanksionohej sistemi parlamentar, presidenti i republikës kishte të drejtë të nxjerrte dekrete ekzekutive mirëpo vetëm sa i takonte themelimit, parimeve të punës dhe rregullimit të çështjes së personelit të Sekretariatit të Përgjithshëm Presidencial (neni 107). Pa dyshim se ky nënkuptonte një akt të njëanshëm të presidentit pa pasur nevojën e mbështetjes në ndonjë normë ligjore.⁴³

Tani fusha e dekretëve ekzekutive është përcaktuar dhe zgjeruar. Presidenti nuk ka të drejtë që me anë të dekretëve të rregullojë çështje të cilat ndërlidhen me të drejtat themelore, të drejtat dhe detyrimet individuale dhe të drejtat dhe detyrimet politike. Dekrete presidenciale nuk mund të nxirren as lidhur me çështjet për të cilat Kushtetuta thotë se rregullohen vetëm me ligj dhe as për çështjet të cilat qartazi janë të rregulluara në ligj.⁴⁴ Pra, bazuar në pjesët e Kushtetutës që flasin për liritë dhe të drejtat, mund të konkludohet se dekretet e presidentit do të jenë të vlefshme vetëm për të drejtat sociale e ekonomike. Përcaktimi i tillë kushtetues deri diku qartëson terrenin e dekretëve presidenciale e rrjedhimisht edhe kufijtë e fuqisë normuese të kreut të shtetit.

Nëse ndodh që dekretet presidenciale të bijnë në kundërshtim me ligjet në fuqi, mbizotëruese do të jenë normat ligjore.⁴⁵ Një gjë të tillë duhet ta vërtetojë pushteti gjyqësor. Kontrollin kushtetues të dekretëve presidenciale mund ta bëjë Gjykata Kushtetuese. Marrë parasysh ndjeshmërinë që mund të paraqitet në një situatë të tillë, ky lloj i kontrollit do të jetë shumë i rëndësishëm.⁴⁶ Por, përgjatë periudhës që

com/haber/referandum-2017/prof-ergun-ozbudun-fesih-ile-secimlerin-yenilenmesi-esanlamli-olarak-kullanilabilir/. (23.04.2018).

⁴² Shih: BİLİR, Faruk. “100 Soruda Hükümet Sistemleri ve Başkanlık Sistemi”. Adalet Yayınevi, Ankara, 2017. f. 84.

⁴³ Shih: ERDOĞAN, Mustafa. “Türkiye’de Anayasalar ve Siyaset”. Liberte Yayınları, Ankara, 2012. f. 227.

⁴⁴ Shih nenin 104 të Kushtetutës.

⁴⁵ Një rregull i tillë vlen edhe për udhëzimet presidenciale.

⁴⁶ GÜLENER, Serdar; MİŞ, Nebi. *Cumhurbaşkanlığı Sisteminin Anayasal Tasarımı*. MİŞ, Nebi; DURAN, Burhanettin. (editör). “Türkiye’de Siyasal Sistemin Dönüşümü ve Cumhurbaşkanlığı Sistemi”. SETA Kitapları 19. İstanbul, 2017. f. 64.

Gjykata shqyrton rastin, do të vazhdojnë së zbatuari dispozitat e dekretit. Kjo shpërfaq faktin se përkundër organit legjislativ, efekti juridik i dekretit mund të jetë më jetëgjatë.

Në rrafshin kushtetues dhe praktik dekretet presidenciale do të zëvendësojnë dekretligjet e qeverisë që parashiheshin me sistemin kushtetues paraprak. Mirëpo, këtu konsiston një dallim i rëndësishëm: dekretet me fuqi ligjore qeveria mund t'i nxirrte vetëm duke u mbështetur në një ligj autorizues, sipas të cilit, pas nxjerrjes, dekretligjet duhej t'i nënshtroheshin miratimit parlamentar. Ndërkaq dekretet presidenciale janë akte *ex officio*, që presidenti i nxjerr me bindjen e vet të lirë.

Me anë të dekreteve presidenciale do të mund të formohen, t'u përcaktohen kompetencat dhe detyrat si dhe të shuhen ministrinë e shtetit (neni 106).

Për më tepër, presidenti do të mund të nxjerrë dekrete edhe gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme. Dekretet e tilla i nënshtrohen aprovimit parlamentar që në ditën e shpalljes. Parlamenti duhet të vendosë brenda një muaji, në të kundërtën dekretit presidencial vetvetiu i humbet fuqia juridike.⁴⁷ Madje, presidentit i njihet edhe kompetenca e shpalljes së Gjendjes së Jashtëzakonshme në rastet e parapara me Kushtetutë (neni 119). Ndërkohë që shtettrrethimi është larguar në tërësi nga teksti kushtetues.

Sipas disa autorëve, nxjerrja e dekreteve presidenciale dhe kompetenca e propozimit të ligjit për buxhetin presidentit ia kanë njohur edhe cilësinë e të qenit ortak me Parlamentin në përdorimin e pushtetit legjislativ.⁴⁸ Disa të tjerë kanë shprehur skepticizëm për këtë kompetencë duke ngritur shqetësimin se shteti mund të shkojë drejt një qeverisjeje me dekrete presidenciale.⁴⁹ Marrë parasysh se presidenti

⁴⁷ Shih: ERDOĞAN, Mustafa. “Başkanlık Sistemi, Latin Amerika Tecrübesi Ve Türkiye”. Liberal Perspektif Analiz Sayı: 3, Aralık 2016. f. 24. <https://serdargunes.files.wordpress.com/2012/11/baskanlik-sistemi-latin-amerika-tecrubesi-ve-turkiye.pdf>. (15.04.2018).

⁴⁸ Shih: ATAY, Ender Ethem. “Hukuk Başlangıcı”. Gazi Kitabevi, Ankara, 2017. f. 193.

⁴⁹ Njëri ndër ta është profesori Hikmet Sami Türk, i cili në një pronocim ishte shprehur se kompetenca e dekreteve presidenciale bie në kundërshtim me parimin e ndarjes së pushteteve dhe mekanizmit “check and balance/frenim dhe balancim” dhe se kjo mund të një në një situatë kur presidenti të qeverisë vetëm me dekrete. Shih: <http://www.dw.com/tr/hukuk%C3%A7ulardan-anayasa-de%C4%9Fi%C5%9Fi-klik-teklifine-sert-tepki/a-36725812>. (23.04.2018).

mund ta ushtrojë edhe të drejtën e vetos, nuk duhet injoruar rrezikun e vështirësimit të nxjerrjes së ligjeve në Parlament.⁵⁰

Megjithatë, nuk duhet harruar se dekrete ekzekutive mund të nxjerrë për shembull edhe presidenti në Francë, edhe pse aty nuk flitet për një sistem të pastër presidencial.

2.4.1. Kontrolli kushtetues i dekreteve presidenciale

Përveç akteve ligjore, Gjykata Kushtetuese ka të drejtë të bëjë kontrollin kushtetues në aspektin formal dhe material edhe të dekreteve presidenciale dhe të Rregullores së Brendshme të Parlamentit. Ndërkaq ndryshimet kushtetuese i kontrollon vetëm në aspektin formal. Referimin e dekreteve presidenciale në Gjykatë Kushtetuese mund ta bëjnë dy grupet më të mëdha parlamentare si dhe së paku 1/5 e të gjithë deputetëve (neni 150). Kështu ka lindur edhe kontrolli abstrakt dhe ai konkret i kushtetutshmërisë së dekreteve presidenciale.⁵¹

Mirëpo, dekretet presidenciale të cilat nxirren gjatë Gjendjes së Jashtëzakonshme ose në gjendje lufte nuk mund të bëhen objekt i kontrollit kushtetues.⁵²

2.5. Vetoja presidenciale

Edhe me ndryshimet e reja presidenti ka të drejtën e vetos për ligjet e nxjerra në Parlament. Nëse Parlamenti ligjin e kthyer e pranon me shumicën e të gjithë deputetëve, presidenti e shpall atë. Ndërsa, në rast se Parlamenti bën ndonjë ndryshim në ligjin e kthyer, presidentit mund ta ushtrojë të drejtën e vetos përsëri (neni 89).

Ndryshimi nga versioni i mëhershëm i Kushtetutës qëndron në kriterin e numrit të deputetëve për të vendosur për ligjin e kthyer. Përderisa më parë pragu i nevojshëm i deputetëve ishte i njëjtë me atë të nxjerrjes së ligjit, tani vërehet se lipset shumica absolute (301 veta) në Parlament. Kjo bën që disa studiues të pohojnë se në sistemin kushtetues turk ka lindur *vetoja përforcuese*.⁵³ Kjo nënkupton që megjithëse e ruan efektin e vet suspensiv (pra, si veto pezulluese), vetoja e presidentit e detyron Parlamentin që në shqyrtimin e ligjit të kthyer

⁵⁰ ATAY, *op. cit.* f. 194.

⁵¹ KESKİNSOY, Ömer. “*Anayasa Hukuku ve Türk Anayasa Hukuku*”. Monopol Yayınları, Ankara, 2017. f. 497.

⁵² Shih nenin 148 të Kushtetutës.

⁵³ Shih: ÖZBUDUN, Ergun. “*Türk Anayasa Hukuku*”. Yetkin Yayınları, Ankara, 2017. f. 329; KESKİNSOY, *op. cit.* f. 494; ATAY, *op. cit.* f. 194.

(që më parë ishte nxjerrë me shumicë të thjeshtë) të vendosë me shumicën e të gjithë deputetëve. Nga kjo rrjedh se vetoja e presidentit nuk e ka vetëm fuqinë pezulluese për një afat të caktuar, por në njëfarë mënyre edhe ndikon në vendimmarrjen e organit legjislativ për shkak se mund të ndodhë që në Parlament të mos mund të sigurohen votat e shumicës absolute për të nxjerrë përsëri ligjin në fjalë.⁵⁴

2.6. Emërimi dhe shkarkimi i zyrtarëve të lartë

Njëra ndër kompetencat e reja të presidentit është edhe emërimi dhe shkarkimi i zyrtarëve të lartë publikë. Por se kush janë këta zyrtarë nuk është theksuar në Kushtetutë. Ky fakt na bën me dije se në këtë çështje Parlamenti nuk do të ketë fjalën e vet për dallim nga SHBA-të ta zëmë, ku emërimin e zyrtarëve të lartë publikë-administrativë (ministrat, ambasadorët, anëtarët e gjyqësorit të lartë etj.) presidenti e bën vetëm pas miratimit të Senatit.⁵⁵ Pra, në SHBA kompetenca e emërimit të tyre është balancuar me fuqinë miratuese të Senatit, ndërsa në sistemin turk një baraspeshë e tillë nuk vërehet. Në SHBA ky bëhet objekt konsensusi mes dy organeve të shtetit gjersa në Turqi presidenti nuk do të ndjejë nevojën për një kompromis të tillë.⁵⁶ Ka studiues konstitucionalë që arsyetimin e emërimit të burokratëve të lartë dhe ministrave bashkë me miratimin e Senatit e ndërlidhin me faktin se në SHBA ekziston rregullimi federal i shtetit.⁵⁷

Në të vërtetë, më se e natyrshme është që kreu i ekzekutivit t'i emërojë e t'i shkarkojë vartësit e vet meqë ai merr përgjegjësinë se me cilin ekip dëshiron të punojë pa pasur presionin për këtë nga Parlamenti. Njëherit kjo do të parandalojë interferimin e shumicës parlamentare në konsolidimin e kabinetit presidencial. Një gjë e tillë mund të cilësohet

⁵⁴ Në origjinalin turqisht: *güçleştirici veto*. Në përkthimin e fjalë për fjalshëm i bie “*veto vështrësuese/përforcuese*”. Termi i tillë në literaturën e teorisë kushtetuese në gjuhën turke përdoret për të definuar veton e presidentit e cila prodhon si efekt juridik nevojën për rritjen e numrit të votave në një shumicë më të cilësuar në Parlament për miratimin e ligjit të kthyer (shën. i autorit). Sipas konstitucionalistit Gözler kjo është e njëjta me atë që në frëngjisht njihet si “*veto relatif*” (veto relative) dhe “*veto partiel*” (veto e pjesshme). Shih: GÖZLER, Kemal. “*Anayasa Hukukunun Genel Esasları*”. Ekin Basım Yayın Dağıtım, Bursa, 2017. f. 355.

⁵⁵ COŞKUN, *op. cit.* f. 17.

⁵⁶ GÖZLER, “*Elveda...*”, f. 59.

⁵⁷ Mendim të tillë ka profesori Kuzu i cili pohon se në SHBA Senati përbëhet nga përfaqësuesit e shteteve federale dhe për më tepër Senati nuk përzihet shpesh në këtë çështje. Ndërkaq, meqë në Turqi ekziston trajta unitare e shtetit varësia nga miratimi i Parlamentit nuk do të ishte në rregull. Shih: KUZU, *op. cit.* f. 212.

si një hap avancues edhe për vetë sistemin presidencial për arsye se presidenti do të bëjë emërimin e zyrtarëve që kanë lidhje me ekzekutivin dhe jo me organin legjislativ. Madje edhe nuk mund të pretendohet për cenim të ndarjes së pushteteve. Mirëpo mos parashikimi i asnjë lloj kontrolli institucional për emërimet në fjalë mbetet të shihet se si do të ndikojë në përdorimin e mekanizmit “check and balance/frenim dhe balancim”.

2.7. Presidenti dhe siguria kombëtare

Sipas Kushtetutës, presidenti i përcakton politikat e sigurisë dhe ndërmer masat e nevojshme. Në emër të Parlamentit përfaqëson Kryekomandën e Forcave të Armatosura Turke.⁵⁸

Gjithashtu presidentit i takon përgjegjësia ndaj Parlamentit për garantimin e sigurisë kombëtare dhe përgatitjen e Forcave të Armatosura në mbrojtjen e vendit. Komandanti i Shtabit të Përgjithshëm që emërohet nga ana e presidentit është komandant i Forcave të Armatosura dhe në kohë lufte ushtron detyrën e kryekomandant në emër të Presidencës (neni 117).

2.8. Përgjegjësia penale e presidentit

Me ndryshimet e reja ka lindur edhe përgjegjësia penale e presidentit që mungonte në sistemin e kaluar.⁵⁹ Akuza ndaj presidentit mund të bëhet nëpërmjet instrumentit të padisë parlamentare. Kjo është e ngjashme me “impeachmentin” në sistemin presidencial.⁶⁰

Sipas kësaj, shumica absolute e deputetëve (301) mund të kërkojë që të iniciohet një hetim me pretendimin se presidenti ka kryer çfarëdolloj krimi. Pranimi i kësaj kërkesë bëhet me 3/5 e deputetëve (360) në votim të fshehtë, një muaj pasi të jetë shqyrtuar. Më pas krijohet një Komision Hetimor i përbërë nga 15 anëtarë, proporcionalisht me numrin e deputetëve të partive politike. Me përfundimin e punës së Komisionit, me 2/3 e numrit të përgjithshëm në votim të fshehtë presidenti mund të akuzohet në Gjykatën Kushtetuese, e cila në

⁵⁸ Këto janë disa nga kompetencat e presidentit të numëruara taksativisht në nenin 104 të Kushtetutës. Përfaqësimi i Kryekomandës në emër të Parlamentit ka qenë e përcaktuar edhe me kushtetutat e mëhershme në Turqi. Për më tepër, shih: KABASHI, *op. cit.* f. 87.

⁵⁹ Sipas versionit paraprak të Kushtetutës së vitit 1982, presidenti mund të akuzohej vetëm për “tradhti ndaj atdheut”. Për më tepër, shih: KABASHI, *op. cit.* f. 71-72.

⁶⁰ ÖZBUDUN, *op. cit.* f. 301.

këtë rast gjykimin do ta bëjë me cilësinë e “Gjyqit Suprem”.⁶¹ Përgjatë periudhës sa zgjat gjykimi, presidenti nuk mund të marrë vendim që vendi të shkojë në zgjedhje të parakohshme dhe nëse Gjyqi Suprem presidentin e shpall fajtor për një krim që do t’ia pamundësonte zgjedhjen, atëherë presidentit i mbaron mandati.⁶² Në të kundërtën, juridikisht mbetet në detyrë.⁶³ Përcaktimi i shifrave të larta të shumicës parlamentare për të vënë në zbatim padinë parlamentare do ta bëjë vështirë të përdorshëm këtë instrument.⁶⁴

Ndërkaq, për shkak të heqjes së instrumenteve të kontrollit si interpelanca dhe mocioni i votëbesimit rezulton se presidenti nuk bart përgjegjësi politike karshi Parlamentit.⁶⁵

2.9. Pozita e zëvendës-presidentit

Pakoja e ndryshimeve parasheh edhe pozitën e zëvendës-presidentit që mund të jetë një ose më tepër persona. Këta, sikurse ministrat, emërohen nga ana e presidentit dhe kanë obligimet e tyre kushtetuese.⁶⁶ Ka opinione se do të ishte më e qëlluar nëse do të parashihej vetëm një zëvendës-president dhe i njëjti të zgjidhej drejtpërdrejtë sikurse presidenti.⁶⁷ Në këtë mënyrë, me një anë populli do të dinte se kush do të jetë zëvendës-president, sepse gjatë fushatës zgjedhore do ta njihite dhe kështu zëvendës-presidenti do të siguronte legjitimitet demokratik dhe, në anën tjetër, kur pozita e presidentit mbetet e zbrazët zëvendës-presidenti i legjitimuar do ta merrte detyrën dhe do ta vazhdonte kontinuitetin në qeverisje.⁶⁸ Vendimet e një zëvendës-presidenti që nuk është zgjedhur nga populli mund të sjellin probleme legjitimiteti, sepse zëvendës-presidenti do t’i marrë kompetencat e presidentit i cili është zgjedhur me vullnetin sovran të qytetarëve dhe kalimi i kompetencave tek një burokrat i emëruar mund të cilësohet si një problem legjitimimi kushtetues.⁶⁹

⁶¹ Në origjinalin turqisht: Yüce Divan (përkth. i autorit).

⁶² Shih nenin 105 të Kushtetutës.

⁶³ ANAYURT, Ömer. “*Hukuka Giriş ve Hukukun Temel Kavramları*”. Seçkin Yayıncılık, Ankara, 2017. f. 365.

⁶⁴ ÖZBUDUN, *op. cit.* f. 328.

⁶⁵ KESKİNSOY, *op. cit.* f. 495.

⁶⁶ Shih nenin 106 të Kushtetutës.

⁶⁷ Shih: COŞKUN, *op. cit.* f. 23.

⁶⁸ *Ibid.* f. 23.

⁶⁹ DOĞAN, *op. cit.* f. 30. Po ashtu, mendim të ngjashëm avokon edhe studiuesja Esen, e cila madje pretendon se duke mos zgjedhur zëvendës-presidentin në mënyrë të

2.9.1. Përgjegjësia e zëvendëspresidentëve dhe ministrave

Pasi që emërohen dhe shkarkohen nga presidenti, zëvendëspresidentët dhe ministrat kanë përgjegjësi karshi shefit të ekzekutivit – presidentit.

Për shkak të ndërrimit të sistemit qeverisjes, Parlamenti nuk mund të iniciojë shkarkimin e tyre duke u thirrur në përgjegjësi politike.⁷⁰ Në këtë aspekt, nëse krimi i pretenduar i tyre lidhet me detyrën që kanë zhvillohet procedurë e njëjtë me atë të akuzimit të presidentit që u shtjellua më lart. Ndërsa, nëse krimi nuk ndërlidhet me fushëveprimin e tyre të përgjegjësive, zbatohen dispozitat e heqjes së imunitetit. Në rastet kur Gjyqi Suprem shpall se kanë kryer krim i cili do t'ua pamundësonte zgjedhjen, zëvendëspresidentëve dhe ministrave u përfundon mandati (neni 106).

3. NDRYSHIMET LIDHUR ME PUSHTETIN GJYQËSOR

3.1. Ridefinimi kushtetues i pushtetit gjyqësor

Sipas ndryshimeve të reja, pushteti gjyqësor që dikur definohej si “i pavarur”, tani i shtohet edhe fjala “i paanshëm” (neni 9).⁷¹ Realisht, vetë natyra e gjyqësorit kërkon që të jetë në paanshmëri kur ushtron veprimtarinë.⁷²

3.2. Suprimimi i gjykatave ushtarake

Ndër pikat e rëndësishme në drejtim të demokratizimit të vendit është edhe norma që i suprimon gjykatat ushtarake (përveç gjykatave disiplinore). Të njëjtat mund të krijohen vetëm në rast lufte për t'i trajtuar krimet e ushtarakëve (neni 142).

drejtperdrejtë ose të tërthortë humbet legjitimiteti demokratik i vetë pushtetit ekzekutiv. Shih: ESEN, Selin. “2016 Anayasa Değişiklik Teklifinin Değerlendirilmesi”. Ankara Barosu Dergisi 2016/4. f. 14-15. <http://dergipark.gov.tr/download/article-file/398633>. (19.04.2018).

⁷⁰ ANAYURT, *op.cit.* f. 366.

⁷¹ Definimi i mëhershëm kushtetues ka qenë: “Pushteti gjyqësor përdoret në emër të popullit turk nga ana e gjykatave të pavarura”, ndërsa tani formulimi është kështu: “Pushteti gjyqësor përdoret në emër të popullit turk nga ana e gjykatave të pavarura dhe të paanshme”. Siç shihet, tani është shtuar edhe kriteri i paanshmërisë.

⁷² Në këtë kontekst, profesori Doğan, duke analizuar këtë risi, thotë se “... vënia e kriterit të paanshmërisë për gjyqësorin në nivel kushtetues mund të interpretohet edhe si një lloj rëfimi se gjykatat turke nuk arrijnë të kryejnë detyrat e tyre në vënie e së paku një drejtësie mesatare (...) Ky ndryshim mund t'i hapë rrugë lehtësimit për të pasur mbështetje juridike në shkarkimin e gjyqtarëve që nuk parapëlqehen nga mazhoranca politike”. Shih: DOĞAN, *op. cit.* f. 23-24.

3.3. Ridefinimi i emrit dhe i përbërjes së Këshillit të Gjiqtarëve dhe Prokurorëve

Me ndryshimet kushtetuese është ndryshuar emri i Këshillit të Gjiqtarëve dhe Prokurorëve (HSK) dhe përbërja e këtij institucioni (neni 159).⁷³ Një pjesë e anëtarëve zgjedhen nga presidenti dhe një pjesë nga Parlamenti. Nëse merret parasysh fakti se presidenti mund të jetën njëkohësisht edhe kryetar partie dhe nëse partia e tij disponon me shumicën parlamentare i bie që, *de facto*, të gjithë anëtarët e Këshillit të emërohen nga ana e presidentit. Kjo mund të sjellë mundësinë që ky institucion të bjerë nën kontrollin e presidentit.⁷⁴ Në aspektin e ndarjes së pushteteve, situata potenciale e tillë lë për të dëshiruar mjaft.

3.4. Ndryshimi i përbërjes së Gjykatës Kushtetuese

Është ndryshuar edhe numri i anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese (neni 146).⁷⁵ Tani, 12 nga 15 anëtarë do të emërohen nga presidenti. 3 të tjerë i zgjedh Parlamenti. Në rundin e fundit të votimit në Parlament kërkohet shumica e thjeshtë (një më shumë se gjysma e të pranishmëve). Në rast se në Parlament deputetët e partisë së presidentit janë më shumë në numër mund të rezultojë që të gjithë anëtarët e Gjykatës Kushtetuese tërthorazi të përzgjidhen nga ana e presidentit. Kjo do të thotë se presidenti si shef i ekzekutivit, me një anë si kryetar partie lidh për vete legjislativin e në anën tjetër me anë të emërimeve që bën lidh edhe gjyqësorin.⁷⁶ Ndryshimi i shpeshtë i numrit të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese dhe i atyre të Këshillit të Gjiqtarëve dhe Prokurorëve ka bërë që të ketë kritika për përpjekje politizimi dhe synimi për të strukturuar përbërjen e anëtarëve të cilët do të ishin në harmoni me mazhorancën politike.⁷⁷ Koha do të tregojë se në praktikë sa do të respektohet e zbatohet parimi i ndarjes së pushteteve.

⁷³ Me ndryshimet e bëra është hequr shprehja “i Lartë” (Yüksek) te “Këshilli i Lartë i Gjiqtarëve dhe Prokurorëve”. (në origjinalin turqisht: Hâkimler ve Savcılar Yüksek Kurulu; shën. i autorit).

⁷⁴ COŞKUN, *op. cit.* f. 25.

⁷⁵ Me supremimin e gjykatave ushtarake, dy anëtarët ushtarakë të Gjykatës Kushtetuese nuk do të jenë më pjesë e saj. Rrjedhimisht, nga gjithsej 17 anëtarë sa kanë qenë, tutje do të jenë 15.

⁷⁶ COŞKUN, *op. cit.* f. 26.

⁷⁷ Bkz. GÖZLER, “*Elveda...*”, f. 61.

4. RIDIZENJIMI I HIERARKISË NORMATIVE DHE HYRJA NË FUQI E NDRYSHIMEVE KUSHTETUESE

4.1. Hierarkia normative në sistemin e ri

Me rregullimin e ri kushtetues ndryshime do të shfaqen edhe në hierarkinë normative. Së këndejmi, piramida do të jetë kjo:⁷⁸

Kushtetuta

Marrëveshjet ndërkombëtare lidhur me të drejtat e njeriut

Ligji – Dekreti presidencial i Gjendjes së Jashtëzakonshme –
Marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

Dekreti presidencial

Udhëzimi

Akte të tjera.

4.2. Hyrja në fuqi e ndryshimeve kushtetuese

Të gjitha ndryshimet kushtetuese nuk kanë hyrë në fuqi menjëherë. Është përcaktuar se dispozita që lejon presidentin të jetë partiak, ajo që suprimon gjykatat ushtarake dhe ajo që ridizenjon Këshillin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve të hyjnë në fuqi menjëherë pas votimit pro në referendum. Ndërsa ndryshimet e tjera do të hyjnë në fuqi pas ditës së zgjedhjeve të para parlamentare e presidenciale.⁷⁹

CONCLUSION

Above all, the new governing system in Turkey has made an essential change in the political system – transition from bicephalism, - that has caused the frequent political crises in the country, - to monocephalic model of the executive, which is considered as a more opportune solution in order to lay the sound basis for political and institutional stability.

In general, the Turkish model of presidentialism with its peculiarities is presented as *sui generis* type. In many aspects different from the well-known models of presidentialism all over the world, this

⁷⁸ Shih: ARDIÇOĞLU, Artuk. “Cumhurbaşkanlığı Kararnamesi”. 2017/3 Ankara Barosu Dergisi. f. 49. <http://www.ankarabarusu.org.tr/siteeler/ankarabarusu/tekmakale /2017-3/1.pdf>. (23.04.2018).

⁷⁹ Fillimisht qe vendosur që zgjedhjet parlamentare dhe presidenciale të mbaheshin me 3 nëntor 2019, mirëpo më pas është marrë vendimi që ato të mbahen parakohe, me datë 24 qershor 2018.

constitutional engineering will necessarily bring about the new unprecedented practices until now.

Renewal of the mutual elections or the solutions offered in the case of the budget, are the innovations in the doctrine and practice arena of the presidential system. Knowing that presidentialism itself may face with some problems which may lead to institutional blockade, such mechanisms may be considered as a tendency for “rationalisation” of this system.

Based on the new competencies guaranteed by the new constitutional normative, there will be a powerful executive authority or, to say it differently, an active president of the state with a rather broad field of activity.

The issue which still remains disputable is the separation of powers as an undeniable base of the modern constitutional law. Contrary to this, the unity of powers has never been a model to solve political crises and, moreover, it is in contradiction with modern conceptions of democracy. With these changes we cannot absolutely pretend that the unity of powers has been built. But, the truth is that there is space to judge that there is a deviation from the classical separation of powers. In the context of state governing, at least theoretically, it is difficult to expect to have the implementation of rigid separation of powers which is present in the presidential system.

The real and factual meaning of the new constitutional norms will come into evidence after the legal infrastructure will be drafted, which will regulate and describe the hypothetical cases in details. Following then the implementation which will clarify the reflection of these changes, making way to more objective evaluation and criticism.

BURIMET E KONSULTUARA

Libra:

ANAYURT, Ömer. “*Hukuka Giriş ve Hukukun Temel Kavramları*”. Seçkin Yayıncılık, Ankara, 2017.

ATAY, Ender Ethem. “*Hukuk Başlangıcı*”. Gazi Kitabevi, Ankara, 2017.

BİLİR, Faruk. “*100 Soruda Hükümet Sistemleri ve Başkanlık Sistemi*”. Adalet Yayınevi, Ankara, 2017.

DOĞAN, İlyas. *Türk Tipi Başkanlık Modeli Bağlamında 2017 Anayasa Değişikliğinin İrdelenmesi*. DOĞAN, İlyas; ÜNVER, Serdar. (editör). “*Dört Kitada Başkanlık Sistemi*”. Astana Yayınları, Ankara, 2017.

ERDOĞAN, Mustafa. “*Türkiye’de Anayasalar ve Siyaset*”. Liberte Yayınları, Ankara, 2012.

ERGÜDER, Üstün. *Başkanlık mı, Parlamenter Sistem mi?*. AKAŞ, Cem (derleyen). “*Kritik Kavşak Parlamenter Sistem – Başkanlık Sistemi*”. Koç Üniversitesi Yayınları, İstanbul, 2015.

GÖZLER, Kemal. “*Anayasa Hukukunun Genel Esasları*”. Ekin Basım Yayın Dağıtım, Bursa, 2017.

GÖZLER, Kemal. “*Anayasa Hukukuna Giriş*”. Ekin Basım Yayın Dağıtım, Bursa, 2015.

GÖZLER, Kemal. “*Elveda Anayasa*”. Ekin Basım Yayın Dağıtım, Bursa, 2017.

GÖZLER, Kemal. “*Referandumdan Önce, Referandumdan Sonra*”. Ekin Basım Yayın Dağıtım, Bursa, 2017.

GÜL, Cengiz. “*Karşılaştırmalı Hükümet Sistemlerinde Yürütme*”. Yetkin Yayınları, Ankara, 2017.

GÜLENER, Serdar; MİŞ, Nebi. *Cumhurbaşkanlığı Sisteminin Anayasal Tasarımı*. MİŞ, Nebi; DURAN, Burhanettin. (editör). “*Türkiye’de Siyasal Sistemin Dönüşümü ve Cumhurbaşkanlığı Sistemi*”. SETA Kitapları 19, İstanbul, 2017.

KABASHI, Ditar. “*Pozita e kreut të shtetit gjatë zhvillimit kushtetues në Republikën e Turqisë – Shqyrtime krahasuese*”. Artini, Prishtinë, 2016.

KESKİNSOY, Ömer. “*Anayasa Hukuku ve Türk Anayasa Hukuku*”. Monopol Yayınları, Ankara, 2017.

KUZU, Burhan. “*Her Yönü ile Başkanlık Sistemi Yeni Sistem Cumhurbaşkanlığı Modelimiz*”. Babıali Kültür Yayıncılığı. İstanbul, 2017.

ÖZBUDUN, Ergun. “*Türk Anayasa Hukuku*”. Yetkin Yayınları, Ankara, 2017.

Punime shkencore, analiza:

ARDIÇOĞLU, Artuk. “*Cumhurbaşkanlığı Kararnamesi*”. 2017/3 Ankara Barosu Dergisi. f. 49. <http://www.ankarabarusu.org.tr/siteler/ankarabarusu/tekmakale/2017-3/1.pdf>. (23.04.2018).

ASLAN, Ali; MİŞ, Nebi; EREN, Abdullah. “*Türkiye’de Cumhurbaşkanlığı’nın Demokratikleşmesi*”. <http://file.setav.org/Files>

/Pdf/20140808184540_turkiye%E2%80%99de-umhurbaskanligi%E2%80%99nin-demokratiklesmesi-pdf.pdf. (21.04.2018).

COŞKUN, Vahap. “16 Nisan 2017 Tarihinde Kabul Edilen Anayasa Değişikliklerinin Değerlendirilmesi”. DÜHFD, Cilt: 22, Sayı: 36, Yıl: 2017, f. 3-30. <http://dergipark.gov.tr/download/article-file/322749>. (20.04.2018).

ERDOĞAN, Mustafa. “Başkanlık Sistemi, Latin Amerika Tecrübesi Ve Türkiye”. Liberal Perspektif Analiz Sayı: 3, Aralık 2016. <https://serdargunes.files.wordpress.com/2012/11/baskanlik-sistemi-latin-amerika-tecrubesi-ve-turkiye.pdf>. (15.04.2018).

ESEN, Selin. “2016 Anayasa Değişiklik Teklifinin Değerlendirilmesi”. Ankara Barosu Dergisi 2016/4. <http://dergipark.gov.tr/download/article-file/398633>. (19.04.2018).

GÖNENÇ, Levent. “2017 Anayasa değişikliği sürecine dair notlar”. http://www.tepav.org.tr/upload/files/1493836530-7.2017_Anayasa_Degisikligi_Surecine_Dair_Notlar.pdf. (23.04.2018).

ULUSOY, Ali D. “Aralık 2016 Anayasa Teklifi Neler Getiriyor, Neler Götürüyor?” <http://www.anayasa.gen.tr/ulusoy-anayasa-degisikligi.pdf>. (08.01.2018).

European Commission for Democracy Through Law (Venice Commission). “Turkey Opinion on the Amendments to The Constitution Adopted By The Grand National Assembly On 21 January 2017 And To Be Submitted To A National Referendum On 16 April 2017.” Opinion No. 875/2017. Strasbourg, 13 March 2017. [http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=cdl-ad\(2017\)005-e](http://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=cdl-ad(2017)005-e). (27.04.2018).

Artikuj, opinione:

https://www.basbakanlik.gov.tr/Forms/_Global/_Government/pg_CabinetHistory.aspx. (14.04.2018).

<https://sonuc.ysk.gov.tr/module/sspsHalkoylamasiYeni.jsf>. (22.04.2018).

“The 2017 Constitutional Referendum in Turkey”. Daily Sabah Centre for Policy Studies. https://www.turkheritage.org/Uploads/715d3c66acf453a7198370af74888b33_Cd5e8NGc.pdf. (22.04.2018).

<http://t.thenewyoungturk.com/haber/referandum-2017/prof-ergun-ozbudun-fesih-ile-secimlerin-yenilenmesi-esanlamli-olarak-kullanilabilir/>. (23.04.2018).

[http://www.dw.c\) om/tr/hukuk%C3%A7ulardan-anayasa-de%
C4%9Fi%C5%9Fiklik-teklifine-sert-tepki/a-36725812.](http://www.dw.com/tr/hukuk%C3%A7ulardan-anayasa-de%C4%9Fi%C5%9Fiklik-teklifine-sert-tepki/a-36725812) (23.04.2018).

Akte juridike:

[https://www.tbmm.gov.tr/anayasa/anayasa_2011.pdf.](https://www.tbmm.gov.tr/anayasa/anayasa_2011.pdf) (28.04.2018).

“*Referandum Değişiklikleri Sonrası Karşılaştırmalı Türkiye Cumhuriyeti Anayasası 1982-2017*”. ÖZMEN, Remzi (hazırlayan). Seçkin Yayıncılık, Ankara, 2017.

Türkiye Cumhuriyeti Anayasasında Değişiklik Yapılmasına Dair Kanun no. 6771 të datës 21.01.2017. (originali në turqisht:) [https://www.tbmm.gov.tr/kanunlar/k6771.html.](https://www.tbmm.gov.tr/kanunlar/k6771.html) (18.04.2018).

Cumhurbaşkanı Seçimi Kanunu, Kanun No. 6271. [http://www.mevzuat.gov.tr/Metin.Asp?MevzuatKod=1.5.6271&sourceXmlSearch=&MevzuatIliski=0.](http://www.mevzuat.gov.tr/Metin.Asp?MevzuatKod=1.5.6271&sourceXmlSearch=&MevzuatIliski=0) (19.04.2018).

[http://anayasadegisikligi.barobirlik.org.tr/Anayasa_Degisikligi.aspx.](http://anayasadegisikligi.barobirlik.org.tr/Anayasa_Degisikligi.aspx) (16.04.2018).